



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:019247

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06738085

KF.nr.890/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Next Group” Sh.P.K. me numër unik identifikues 810168105 dhe seli në Ferizaj, përfaqësuar nga Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt i kontestit rivlerësim doganor, vlerë e kontestit 1,024.87€ në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 14.01.2025 në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur Xh. K., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit “Next Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810168105 dhe seli në Ferizaj.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/1024/2021 i datës 19.07.2022 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit “Next Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810168105 dhe seli në Ferizaj, t’ia kthej shumën prej 1,024.87€ (një mijë e njëzetë e katër euro e tetëdhjetë e shtatë cent) të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr.R-31629/24.12.2020, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Ferizaj, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e pagesës së detyrimeve doganore 25.12.2020, e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Next Group” ShPK, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në gjykatë me datë 26.08.2022, për herë të dytë ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave, UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së parimeve dhe rregullave të procedurës administrative, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi i kontestuar i të paditurës, si dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara në emër të detyrimeve të importit në shumë prej 1,024.87€, me kamatë në shkallë prej 8% nga dita e pagesës 24.12.2020 e deri në kthimin e plotë. Tutje, paditësi në padi, dhe në parashtrësën e datës 13.01.2025 ka deklaruar se paditësi edhe më tutje qëndron në tërësi si në të theksuarat në padi, duke kërkuar nga gjykata që të shqyrtohen shkeljet ligjore të shkaktuara nga e paditura, përkatësisht nenit 33 të KDAK-së lidhur me nenin 123 të UA 11/2009, gjë e cila vërtetohet me anë të provave të bashkangjitura padisë, përkatësisht fatura nr.ASI2020000000113 e datës 18.12.2020 dhe Paking List, Urdhërpagesa bankare në emër të faturës e datës 24.12.2020, Deklarata Eksportuese turke e datës 19.12.2020, fatura e shpenzimeve të transportit dhe CMR. Nga dokumentet e përshkruara dhe të evidentuara si me lartë, vërtetohet se importuesi ka poseduar dhe prezantuar të gjitha dokumentet e nevojshme në bazë të të cilave ka mundur të vërtetohet vlera e mallit, mirëpo zyrtarët doganor duke u thirrur në shënimet referente me të meta që u potencuan në padi kanë bërë një rivlerësim jo objektiv dhe të kundërligjshëm të mallit. Paditësi i kundërshton pretendimet në përgjigjen në padi, sepse provat e bashkangjitura nuk vërtetojnë çmimin e mallit kontestues, sepse nuk përmbajnë të dhëna për mallra të njëjta dhe me parametra të njëjta tregtar, ashtu që të bëhet krahasimi adekuat i tyre. Tutje përfaqësuesi i paditësit i propozon gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar, të anulohet aktvendimi i Sektorit të Rishqyrtimeve të Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/1024/2021 i datës 19.07.2022 dhe të detyrohet e paditura t’i kthej paditësit mjetet e paguara në emër të detyrimeve të importit të paguara mbi vlerën e transaksionit sipas DUD R-31629/24.12.2020, për shkak të rivlerësimit në shumën prej 1,024.87€, me kamatë në shkallë prej 8% nga data e pagesës 25.12.2020 e deri në kthimin e plotë. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

E paditura Dogana e Kosovës në përgjigjen në padi të datës 17.10.2024, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se vendimi i atakuar

është marrë konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë në shkelje ligjore nuk qëndron fare, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se pretendimet e paditësit të shprehura në padi nuk qëndrojnë se kinse e paditura ka bërë shkelje të KDAK-së e në lidhje me UA nr.99/2011 si dhe UA 11/2009. Këto pretendime janë të pabazuara sepse dispozitat e kodit doganore në kapitullin për vlerësimin e mallit në procedure doganore të paraqitur nga importuesi shprehet qartazi se kur Dogana e Kosovës si organ kompetent konstaton se paditësi ka deklaruar vlera më të ulëta në raport me të dhënat që i disponon dogana, atëherë janë autorizimet ligjore për rivlerësimin e mallit e që në këtë rast është vlerësuar me MV6. Pretendimi tjetër i paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotës të gjendjes faktike gjithashtu është pretendim i pa bazuar sepse gjendja faktike është vërtetuar me rastin e shikimit të mallit dhe ku është përcaktuar se paditësi ka deklaruar vlera më ulëta nga ajo që disponon e paditura. Gjithashtu e kundërshtojnë edhe parashtresën e paditësit të dorëzuar gjatë kësaj seance e cila në përmbajtjen e saj ka përshkrime nga padia e paraqitur në këtë gjykatë. Ndërsa sa i përket precizimit të vlerës së kontestit e njëjta është e saktë. Nga administrimi i provave vërtetohet se paditësi me rastin e deklarimit të mallit ka deklaruar vlera më të ulëta në raport me të dhënat që i disponon Dogana e Kosovës dhe për këtë arsye i gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të lë në fuqi aktvendimin e Doganës së Kosovës. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 14.01.2025, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat relevante dhe atë: Aktvendim 01.3.2.2/1024/2021 datë 19.07.2022, DUD R31629 datë 24.12.2020, Deklaratë eksportuese datë 19.12.2020, Faturë nr. ASI202000000113 e datës 18.12.2020, Pagesë ndërkombëtare e datës 24.12.2020, Faturë e transportit nr.0429/2020, CMR e datës 22.12.2020, Aktgjykim A.nr. 845/21, Aktvendim 01.3.2.2/1024 datë 05.03.2021, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Dosja me të dhënat e disponueshme, Ankesë në doganë e datës 20.01.2021, Packing list, Transaksioni për pagesën e taksave doganore datë 25.12.2020.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 44 të LKA-së, ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi,

deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për këto arsye:

Nga provat shkresore të administruara në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës, duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.845/21 të datës 20.06.2022, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e këtui paditësit, ishte anuluar aktvendimi i të paditurës me nr.01.3.2.2/1024 i datës 05.03.2021, dhe lënda ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Me aktvendimin e kontestuar me nr.01.3.2.2/1024/2021 i datës 19.07.2022, e paditura e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit me nr.R-31629/24.12.2020 të ZBD-së Ferizaj. E paditura në arsyetim të vendimit të kontestuar ka theksuar se çmimi i marr nga dosja e vlerës është çmim i përcaktuar në bazë të llojit të mallit dhe në bazë të karakteristikave tjera të cilat janë të detajuara e sipas të cilave është caktuar vlera e mallit, andaj për këtë arsye Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka vendosur në këtë çështje, ndërsa mospërputhja e vlerës së deklaruar dhe vlerës së përcaktuar në bazë të dosjes së vlerës ka ndikuar që vlerësimi i mallit të bëhet duke u bazuar në të dhënat që Dogana e Kosovës ka në dispozicion.

Gjykata konstaton se paditura me rastin e nxjerrjes së aktvendimit të kontestuar, e ka nxjerr përsëri aktin e mëhershëm të anuluar nga gjykata me aktgjykimin A.nr.845/21 të datës 20.06.2022, përkatësisht aktvendimin me nr.01.3.2.2/1024 të datës 05.03.2021. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata vlerëson se e paditura ka dështuar t'i respektoj pikëpamjet juridike të gjykatës dhe vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën administrative të ndjekur tek e paditura, për arsye se, e paditura në ri procedurë ishte obliguar nga gjykata që të deklarohet lidhur dokumentacionin përcjellës të mallit të paraqitur nga paditësi, ku përfshihet fatura si dhe transaksioni bankar për pagesën e mallit lëndor, dhe pas konstatimit të gjendjes faktike të marr vendim të drejtë dhe të bazuar në dispozitat ligjore të KDAK-së.

Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe në kundërshtim me dokumentacionin përcjellës të mallit të paraqitur nga paditësi, e ka rivlerësuar mallin lëndor të zhdoganuar nga paditësi dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë, me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 1,024.87€, vlerë kjo e cila nuk është kontestuar gjatë seancës së shqyrtimit kryesor as nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës.

Gjykata konstaton se me asnjë provë relevante nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Gjykata vlerëson se e paditura do të mund ta mbështeste një konstatim të këtillë, vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor të importuar dhe të zhdoganuar përmes DUD-it R-31629/24.1202020 të ZBD-së Ferizaj, i ka paguar shitësit të mallit-eksportuesit “Asil Group IC VE DIS” nga Turqia mbi çmimin e faturës së mallit me nr.ASI2020000000113 të datës 18.12.2020, ku vlera e mallit të faturuar nga shitës-eksportuesi është 32,312.79€, vlerë kjo edhe e paguar nga paditësit si importues-blerës i mallit, sipas transaksionit bankar të datës 24.12.2020, në shumë prej 32,912.79€, me përshkrimin bankar “*Payment of proforma invoice no:ASI2020000000113, Payment for hair products*”, aq sa e ka deklaruar vlerën e mallit paditësi në rubrikën 22 të DUD-it të kontestuar.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore të dhënat nga Dosja e Vlerës e Doganës së Kosovës, në të cilën thirret e paditura në vendimin e kontestuar, kjo sepse çështja e vlerës së mallrave për qëllime doganore është e rregulluar me dispozitat e neneve 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe aty në asnjë vend nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e të dhënave të disponueshme nga Dogana e Kosovës, përkatësisht dosja e vlerës, ku është bazuar e paditura kur e ka rivlerësuar mallin e paditësit.

Gjykata konstaton se në nenin 33 par.1 të KDAK-së përcaktohet se “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*”. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që “*Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë*”.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që, dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Gjykata konstaton se për të provuar vlerën e deklaruar të mallit lëndor me DUD-in nr.R-31629/24.12.2020, paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallit dhe në procedure ankimore tek e paditura, por edhe në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, ka paraqitur si provë dokumentacionin përcjellës të mallit në përbërje prej: faturën e blerjes së mallit me nr. ASI2020000000113 të datës 18.12.2020, ku vlera e mallit të faturuar nga shitësi-eksportuesi është 32,312.79€, transaksionin bankar të datës 24.12.2020, në shumë prej 32,912.79€, me përshkrimin bankar *“Payment of proforma invoice no:ASI2020000000113, Payment for hair products”* si dhe deklaratën eksportuese të datës 19.12.2020. Gjykata konstaton se të gjitha këto dokumente janë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar dhe çmimit të transaksionit të paguar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Rrjedhimisht, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t’i kthej shumën prej 1,024.87€ të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit jo të drejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes DUD-it kontestues të proceduar në ZBD Ferizaj, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e pagesës 25.12.2020 e deri në kthimin e plotë.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas kërkesës së paditësit, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet *“Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”* dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se *“Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”* dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet*

ndryshe me ligj të veçantë”, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës sipas kërkesës së palës paditëse ka marrë datën 25.12.2020 si datë e pagesës.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.890/22, datë 14.01.2025

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.